



Nova Demokratska Stranka NDS

Pasqyrat Financiare Vjetore dhe Raporti i Auditorit të pavarur

01 Janar 2020 - 31 Dhjetor 2020

Përmbajtja:

Raport i auditorëve të Pavarur..	3
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	7
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	8
Informata të përgjithshme	9
Shënimet e pasqyrave financiare.....	10 - 14

Raport i Auditorëve te pavarur

Drejtuar Kryesisë së Nova Demokratska Stranka

Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

Mohim i Opinionit

Ne kemi qen te angazhuar për te audituar raportet financiare bashkëngjitura të Subjektit Politik “Nova Demokratska Stranka” (në vijim referuar si “Subjekti Politik” apo “NDS”), te përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 Dhjetor 2020, Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve për periudhën e përfunduar me këtë date , dhe informacionin tjetër shpjegues te përfshira ne fq 7-14

Ne nuk shprehim një opinion mbi raportet financiare te vitit 2020 te subjektit politik “Nova Demokratska Stranka”. Për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në paragrafin bazat për mohim të dhënies së opinionit, ne nuk kemi qenë në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme të auditimit për të patur një bazë për një opinion të auditimit.

Bazat për mohim te opinionit

- Subjekti Politik nuk ka plotësuar drejt pasurinë, ekuitetin dhe detyrimet m me 31 Dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019, po ashtu shënimet e prezantuara në Pasqyra Financiare nuk mbështeten me dëshmi relevante lidhur me zërat e pasqyrave financiare të SP me 31 Dhjetor 2020 ashtu siç kërkohet me ligjin Nr. 04/L-212 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuara dhe plotësuara me ligjin Nr. 04/L-058, Neni 15 Raportimi Financiar. Pas parasysh natyrën e shënimeve që mban subjekti politik ne e kishim te pamundur te përcaktojmë korrigjimet e nevojshme me 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019.
- Ashtu siç është shpalosur ne shënimin 7. Paraja dhe ekuivalentet e parasë, SP me 31 Dhjetor 2020 ka prezantuar para ne arke ne vlere ne vlere prej 3,469.42 Euro (31 dhjetor 2019; 564.35 Euro). Ne mungese te dokumentacionit mbështetës për vlerën e parasë te prezantuara, ne e kishim te pamundur te verifikojmë ekzistencën, plotësinë dhe vlerën e parasë me 31 dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019.
- Ashtu siç është shpalosur ne shënimin 9. Detyrimet tjera afatshkurtra, SP me 31 Dhjetor 2019 ka prezantuar detyrime tjera ne vlere ne vlere prej 6,445.28 Euro. Ne mungese te dokumentacionit mbështetës për vlerën e detyrimeve te prezantuara, ne e kishim te pamundur te verifikojmë ekzistencën, plotësinë dhe vlerën e detyrimeve tjera te prezantuara me 31 dhjetor 2019.
- Ashtu siç është shpalosur ne shënimin 2. Shpenzimet, SP ka deklaruar totalin e shpenzimeve ne vlere 28,030.58 EURO. Subjekti politik ka dështuar te ofroj dokumentacion mbështetës për vlerën 21,052.83 EURO te shpenzimeve te

prezantuar, prandaj ne e kishim te pamundur te verifikojmë, saktësinë, ekzistencën, klasifikim dhe ndodhjen e këtyre shpenzimeve.

- Në mungese të konfirmimeve bankare ne e kishim të pamundur të verifikojmë nëse SP ka vetëm një llogari bankare ashtu siç kërkohet me ligjin NR. 04/L-212 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-058, neni 11, paragrafi 3.

Theksim i çështjes

Ne po ashtu tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Subjekti Politik nuk ka mirëmbajtur një kontabilitet te mirëfilltë për ti mundësuar regjistrimin e transaksioneve financiare dhe përgatitjen e pasqyrave financiare sipas standardeve te kontabilitetit te aplikueshme ne Kosove.
- Subjekti Politik nuk e ka te definuar me Statut, mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar të saj dhe të drejtën e anëtarëve për t'u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjës për transaksione financiare, ashtu siç parashihet ne ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 17 Kontrolli i Brendshëm.
- Subjekti Politik nuk ka respektuar kërkesat ligjore ne lidhje me publikimin e raporteve financiare vjetore dhe te fushatës sipas ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar, paragrafi 5.1 dhe 5.2.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre te ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, te çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës se kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operationet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë

raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.


Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit & Conto sh.p.k


Ymer Shatri
Auditor Ligjor
6 Tetor 2021



NOVA DEMOKRTASKA STRANKA

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2020

Pasqyra e Pozitës Financiare

Pasuritë		Me 31 Dhjetor 2020	Me 31 Dhjetor 2019
Pasuritë afatgjata	Shënimi	Shuma në Euro	Shuma në Euro
Toka, objektet dhe pajisjet	5	0.00	0.00
Pasuritë e paprekshme		0.00	0.00
Pasuritë tjera afatgjata		0.00	0.00
Total pasuritë afatgjata		0.00	0.00
Pasuritë afatshkurtra			
Llogaritë e arkëtueshme			
Parapagimet			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	3	3,469.42	564.35
Pasuritë tjera afatshkurtra			
Total pasuritë afatshkurtra		3,469.42	564.35
Total pasuritë		3,469.42	564.35
Ekuiteti			
Fondet e akumuluar		0.00	0.00
Suficiti / (deficiti) i vitit		3,469.42	(6,445.28)
Total Ekuiteti		3,469.42	(6,445.28)
Detyrimet			
Detyrimet afatgjata			
Huatë e pagueshme		0.00	0.00
Të hyrat e shtyera	5	0.00	0.00
Gjithsej detyrimet afatgjata		0.00	0.00
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	8	0.00	564.35
Huatë e pagueshme			
Detyrimet tjera afatshkurtra	9	0.00	6,445.28
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		0.00	7,009.63
Gjithsej detyrimet		0.00	7,009.63
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		3,469.42	564.35

Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve

	Shënimi	Viti që përfundon me 31 Dhjetor	
		2020	2019
Të hyrat			
Të hyrat nga buxheti		31,500.00	23,625.00
Të hyrat nga anëtarësia			
Donacionet dhe kontributet në të holla	3		38.54
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime	4		
Të hyrat e fushatës			7,875.00
Te hyrat e liruara nga te hyrat e shtyera	5		
Të hyrat tjera			
Gjithsej të hyrat për vitin		31,500.00	31,538.54
Shpenzimet			
Pagat dhe kompensimet	2	17,741.75	4,813.99
Shpenzimet e transportit	2	732.00	1,941.81
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	2	4,950.00	6,648.84
Shpenzimet e fushatës	2	0.00	13,901.30
Blerja e mallrave	2	660.00	4,888.74
Shpenzimet e përgjithshme	2	2,576.83	4,552.59
Shpenzimet e ndryshme	2	1,370.00	1,198.01
Gjithsej shpenzimet për vitin		28,030.58	37,945.28
Suficiti / (deficiti) për vitin		3,469.42	(6,406.74)

1. Informata te përgjithshme

NOVA DEMOKRATSKA STRANKA

Udhëheqja: Emilija Regjepi (Kryetare e partisë)
Përfaqësues i autorizuar financiar – Naser Meta

Selia e partisë: Rr. Qazim Berisha nr.23 ,
Prizren

Pasqyrat financiare te Nova Demokratiska Stranka janë përgatitur sipas kërkesave te Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar.

Bazuar në nenin 19 paragrafi 2 pika 7 e Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 ,Subjekti i regjistruar politik brenda pesë (5) ditëve të punës nga marrja e draft raporteve të audituara ka dorëzuar raportin e rishikuar financiar dhe shpjegimet lidhur me gabimet ose lëshimet të identifikuara nga auditorët.

Subjekti Politik mirëmban llogari kryesore bankare ne bankën PCB.

NOVA DEMOKRTASKA STRANKA

Shënimet për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2020 deri më 31 Dhjetor 2020

Shënimi 2. Shpenzimet

Shpenzimet	Shpenzimi në Euro	Pagesa në Euro	Borxhi i mbetur në Euro
Pagat dhe kompensimet			
Pagat dhe kompensimet, neto	2,750.00	2,750.00	0.00
Kontributet pensionale të punëmarrësit	153.00	153.00	0.00
Kontributet pensionale të punëdhënësit	153.00	153.00	0.00
Tatimet në të ardhura personale	185.75	185.75	0.00
Beneficionet tjera	14,500.00	14,500.00	0.00
Gjithsej	17,741.75	17,741.75	0.00
Shpenzimet e transportit			
Automjetet motorike të huazuara			0.00
Karburantet	732.00	732.00	0.00
Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksit etj.			0.00
Sigurimi dhe mirëmbajtja e veturave			0.00
Çdo shpenzim tjetër i transportit			0.00
Gjithsej shpenzimet e transportit	732.00	732.00	0.00
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat			
Lokali			0.00
Ushqimi	4,000.00	4,000.00	0.00
Aktivitete kulturore dhe rekreative			0.00
Radio dhe spotet televizive			0.00
Stendat e afishmit dhe reklamimet në gazeta			0.00
Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave	950.00	950.00	0.00
Gjithsej reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	4,950.00	4,950.00	0.00
Shpenzimet e fushatës			

NOVA DEMOKRTASKA STRANKA

Shënimet për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2020 deri më 31 Dhjetor 2020

Shpenzimet e fushatës			0.00
Gjithsej shpenzimet e fushatës	0.00	0.00	0.00
Blerja e mallrave			
Furnizimi i zyrës	660.00	660.00	0.00
Pajisjet të vogla			0.00
Gjithsej blerja e mallrave	660.00	660.00	0.00
Shpenzimet e përgjithshme			
Qiraja e lokalit të zyrës	2,000.00	2,000.00	0.00
Telefoni, interneti dhe posta	450.00	450.00	0.00
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)	126.83	126.83	0.00
Shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë		////////////////////	////////////////////
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet në natyrë në mallra dhe shërbime		////////////////////	////////////////////
Gjithsej shpenzimet e përgjithshme	2,576.83	2,576.83	0.00
Shpenzimet e ndryshme			
Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës	950.00	950.00	0.00
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër	420.00	420.00	0.00
Gjithsej shpenzimet e ndryshme	1,370.00	1,370.00	0.00
Gjithsej shpenzimet	28,030.58	28,030.58	0.00

NOVA DEMOKRTASKA STRANKA*Shënimet për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2020 deri më 31 Dhjetor 2020***Shënimi 3: Donacionet dhe kontributet në të holla**

Pranuar nga				Vlera	E pranuar përmes:	
Kontribuesi	Adresa	Numri personal	Data kur është dhënë kontributi	në euro	Bankë	Arkë
Gjithsej donacionet dhe kontributet në të holla				0.00	0.00	0.00

Shënimi 4: Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime

Përshkrimi i mallit / shërbimit	Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera në euro
	Kontribuesi	Adresa	Numri personal		
Gjithsej kontributet në natyrë në mall dhe shërbime					0.00

NOVA DEMOKRTASKA STRANKA

Shënimet për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2020 deri më 31 Dhjetor 2020

Shënimi 5: Toka, objektet dhe pajisjet

	Bilanci në fillim të vitit (kosto historike)	Blerjet gjatë vitit	Zhvlerësimi i akumuluar	Zhvlerësimi i vitit	Bilanci në fundë të vitit (vlera neto)
Toka					0.00
Objektet					
Veturat					
Pajisjet e zyrës					
Pajisjet e teknologjisë informative					
Pajisjet tjera					
Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet					

Shënime tjera

Shënimi 6. Llogari të arkëtueshme	Me 31 Dhjetor 2020 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2019 Shuma në Euro
.....blerësi 1		
.....blerësi 2		
Gjithsej Llogarit e arkëtueshme	0.00	0.00

Shënimi 7. Paraja dhe ekuivalentët e parasë	Me 31 Dhjetor 2020 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2019 Shuma në Euro
Paraja në bankë		564.35
Paraja në arkë	3,469.42	
Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë	3,469.42	564.35

NOVA DEMOKRTASKA STRANKA*Shënimet për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2020 deri më 31 Dhjetor 2020*

Shënimi 8. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	Me 31 Dhjetor 2020 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2019 Shuma në Euro
.....furnitori 1		
.....furnitori 2		
.....furnitori 3		
.....furnitori 4		
Llogari te pagueshme te tjera		564.35
Gjithsej llogaritë e pagueshme dhe të tjera	0.00	564.35

Shënimi 9. Detyrimet tjera afatshkurtra	Me 31 Dhjetor 2020 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2019 Shuma në Euro
Detyrimet për paga dhe tatime		
Detyrimet për qira		
Detyrimet për gjoba dhe ndëshkime		
Detyrime tjera afatshkurtër (huazimet)		6,445.28
Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra	0.00	6,445.28

Shënimi 10: Pagesat mbi 5,000.00 Euro

Qëllimi i pagesës	Paguuar ndaj:			Data kur është bërë pagesa	Vlera në euro
	Përsoni Fizik/Juridik	Adresa	Numri personal		
Gjithsej pagesat mbi 5,000.00 Euro					0.00